

SBASHK Arsimimi sot

Shkurt, 2023

Gazeta elektronike

Aktivitete të SBASHK-ut në shumë komuna të Kosovës **Interesim i madh për trajnimin e programeve kompjuterike**



Stafi qendror i SBASHK-ut në koordinim me kryetarët dhe veprimtarët tjerë sindikalë nga shumë komuna të Kosovës kanë realizuar shumë aktivitete sindikale në shërbim të anëtarësisë edhe në muajin shkurt. Çdo fundjavë e këtij muaji është kthyer në ditë pune e angazhimi. Kështu ishte edhe në komunën e Prizrenit, Suharekës, Podujevës, Drenasit, Skenderajt e në komuna të tjera. Në pjesën e fundit të muajit shkurt u dallua Prizreni. Në institucionin shembullor arsimor në këtë komunë "Ymer Prizreni" janë gjendur qindra ... (faqe 4)

Kuvend pune i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë
Bashkëbisedë e përfaqësuesve të SBASHK-ut me veprimtarët sindikalë



Në kuadër të realizimit të ... (faqe 5)

Vazhdoi të realizohej agjenda e takimeve me veprimtarë sindikalë

Kuvend pune i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Lipjan

Në muajin shkurt e... (Faqe 7)

Flet për gazeten tonë kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj



Po afrohet 7 Marsi, dita e madhe e mësuesit ... (faqe 3)

Kuvend pune në Suharekë
Takim me kryetarin e komunës Bali Muharremi e drejtorin e arsimit z.Bajselmani



Duke realizuar agjendën e pjesëmarrjes ... (faqe 6)

Editorial

Një muaj i veçantë për historinë e kombit tonë



Në fillimin e çdo marsi shqiptarët kudo janë kthejnë kujtesën për datat dhe ngjarjet e mëdha që kanë lënë gjurmë në përpjekjet e njerëzve të pendës e armës për lirinë e atdheut. Kujtojmë me krenari pishtarët e parë të dijes dhe gjithë pasardhësit e tyre që nëpër kohë furtunash mbrojtën dritën kundër errësirës që mundoheshin ta sjellnin e rrënjosnin mbi atdheun tonë pushtuesit. Më 7 mars kudo në institucione arsimore me programe artistike lartësojmë kujtimin dhe shprehim krenarinë e falënderimet për ata që bënë sakrifica sublime në misionin e shenjtë

të arsimimit e edukimit të brezave. SBASHK nëpër komuna zhvillon aktivitete të shumta dhe në shenjë respekti për angazhimet nëpër vite e dekada ndanë mirënjohje për koleget dhe kolegët e pensionuar.

Në fillimet e çdo marsi qytetarët e Kosovës dhe nga vise të tjera shqiptare shkojnë në Prekazin e historisë dhe lartësojnë kujtimin për komandantin Adem Jashari dhe heronjtë e dëshmorët e tjerë të kombit, që me gjakun e tyre i vunë themelët e lirisë së Kosovës. Një muaj i veçantë për historinë e kombit tonë dhe ne të gjithë duke thënë vargjet nga kënga “Sërisht vjen marsi” shprehim respekt për dëshmorët e heronjtë e kombit, por edhe për heronjtë e gjallë kudo janë ata.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitonit ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitonit të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rrëth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Flet për gazeten tonë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj
SBASHK-u me histori të veçantë sindikale



Po afrohet 7 Marsi, dita e madhe e mësuesitdheshkollës shqipe dhe përgazetën "Arsimimi sot" zhvilluan një bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj.

Në këtë bisedë pyetjet janë pak më ndryshe krahasuar me intervistat e paraqitjet në medie që ka pasur deri tani kryetari Jasharaj.

Arsimimi sot:

Dita kombëtare e mësuesit po afrohet. Kujtesa juaj kthehet nëpër vite e dekada.

Jasharaj :

Marsi është një muaj i veçantë i vitit për popullin tonë sepse pikërisht në këtë muaj gjatë shekujve, dekadave e viteve kanë ndodhur ngjarje të mëdha përfatim e kombit tonë. Marsi na sjell kujtime për shkollën e parë shqipe, por edhe pishtarët e dijes që nëpër kohë plot furtuna mbrojtën drithën kundër errësirës që mundohej ta sillte pushtuesi në këto troje. Marsi është muaji kur Komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja e tij i ndërruan kahjen historisë dhe u bën themel i lirisë së Kosovës. Në fillim të çdo marsi shqiptarët nga të gjitha trojet lartësojnë kujtimin përpishtarët e dijes dhe përheronjtë e dëshmorët e kombit.

Arsimimi sot:

Për vite me radhë je kryetar i SBASHK-ut. Na shpalos kujtime nga momente të veçanta.

Jasharaj :

Që nga fillimi jam pjesë e SBASHK-ut. U mundova ta arsyetoj besimin që kolegët ma kishin dhënë që në fillet e aktivitetet e SBASHK-ut kur kërkohej unitet dhe angazhim përmbrojtjen e arsimimit në gjuhën tonë në vitet e 90-ta. Nga ato kohë kam shumë kujtime sepse ishin kohë të sakrificave. Kujtoj me

respekt të lartë gjithë punëtorët arsimorë të asaj kohe që punuan me përkushtim në misionin e tyre të shenjtë. Kujtoj me respekt të lartë koleget e kolegët që kaluan në amshim. Në SBASHK i përjetshëm do të jetë kujtimi përta. Kujtoj edhe ata që Covid i bërë mik me vdekjen na i mori. Kujtoj të gjithë këta dhe ndjej dhembje e pikëllim sepse ne nuk ishim me njëri-tjetrin thjesht veprimtarë sindikalë, por ndjeheshim si një familje dhe siç thonë në Shkodër, qeshnim e qanim së bashku. Kujtoj gjithë ata që u pensionuan e që përvite ishim në aktivitete sindikale. Gëzohem kur ata vijnë në zyre e bashkëbisedojmë gjatë duke kujtuar vitet e kaluara, që ishin edhe të vështira, por edhe të stolisura me shumë angazhime e arritje të SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Çka në vitin 2023?

Jasharaj :

Do të vazhdojmë me stafin qendror dhe me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve të angazhohemi me tërë mundësitetë në shërbim të anëtarësisë. Jemi përballur me mjaft sfida në vitin e kaluar, por SBASHK-u mbeti bashkë e në SBASHK dhe sfida tepër e vështirë e riregjistrimit në eKosova po tejkalohet sepse numri i të riregjistruarve në SBASHK vazhdimesh po shtohet dhe kjo dëshmon përbesimin e ndërsjellë mes anëtarësisë dhe udhëheqësve sindikal.

Gjatë muajit

Aktivitete të SBASHK-ut në shumë komuna të Kosovës

Interesim i madh për trajnimin e programeve kompjuterike

Stafi qendror i SBASHK-ut në koordinim me kryetarët dhe veprimtarët tjerë sindikalë nga shumë komuna të Kosovës kanë realizuar shumë aktivitete sindikale në shërbim të anëtarësisë edhe në muajin shkurt. Çdo fundjavë e këtij muaji është kthyer në ditë pune e angazhimi. Kështu ishte edhe në komunën e Prizrenit, Suharekës, Podujevës, Drenasit, Skenderajt e në komuna të tjera.



Në pjesën e fundit të muajit shkurt u dallua Prizreni. Në institucionin shembullor arsimor në këtë komunë "Ymer Prizreni" janë gjendur qindra kolege e kolegë të ndarë në nëntë grupe për të përcjell me vëmendje trajnimet e licencura të SBASHK-ut. Këtë institucion arsimor të shtunën e 25 shkurtit e kanë vizituar kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prizrenin, Reshit Kushaj.



Ata fillimi isht janë takuar me drejtoreshën e këtij institucioni arsimor, znj. Myvedete Gajvazi dhe me kryetarin e shoqatës sindikale Selajdin Badallaj. Drejtoresha Gajvazi ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën duke vlerësuar lart angazhimin

e tyre në shërbim të anëtarësisë e pastaj ka njoftuar mysafirët për punën edukativo-arsimore që zhvillohet me përkushtim në këtë institucion arsimor. Kryetari Jasharaj ka përgëzuar drejtoreshën Gajvazi dhe gjithë të punësuarit në këtë institucion arsimor, që mban emrin e një personaliteti të shquar të historisë sonë kombëtare e pastaj kanë vizituar ambientet e kësaj shkolle për të parë nga afër kushtet e shkëlqyera që janë krijuar këtu për një arsimim sa më cilësor.



Pas kësaj ata kanë vizituar të nëntë grupet e trajnimeve duke bashkëbiseduar me trajnerët dhe me pjesëmarrësit. Duke bashkëbiseduar me koleget e kolegët në trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm", kryetari Jasharaj është shprehur se SBASHK-u është i nderuar që këtë trajnim shumë të rëndësishëm po e udhëheq në Prizren një emër i njobur, prof. dr. Bardh Rugova, që është edhe anëtar i Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës.



Kryetari Jasharaj me respekt të veçantë ka falënderuar edhe trajnerin Sami Shala dhe gjithë Departamentin

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës që po japid kontribut me vlerë në trajnimin “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin demokratik”. Përfaqësuesit e SBASHK-ut bashkë me drejtoreshën Gajvazi kanë vizituar edhe grupet e mësimdhënësve në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, që po udhëhiqen nga trajnerët Albert Samadraxha, Arben Zymeri, Nexhmendin Gruda e Xhelal Krasniqi.



Kryetari Jasharaj ka përgëzuar koleget e kolegët për punën e përkushtuar në arsim, për unitetin e respektin ndaj SBASHK-ut dhe për entuziazmin që edhe në ditë vikendi të angazhohen për arritje të njojurive të reja që do t'i vënë në funksion të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim.



Kuvend pune i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrris Bashkëbisedë e përfaqësuesve të SBASHK-ut me veprimtarët sindikalë



Në kuadër të realizimit të agjendës së takimeve me veprimtarë sindikalë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkyretaren Vjollca Shala dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar komunën e Vushtrrisë. Para se të fillonte ky takim ata të shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Vushtrrinë Visar Sadriu janë takuar me kryetarin e kësaj komune Ferit Idrizi. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë falënderuar kryetarin Idrizi për korrektsinë

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë bashkëbiseduar edhe me koleget e kolegët tanë që po përcillnin trajnimet “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimit Parauniversitar”, me trajnerin prof. dr. Hysen Sogojeva, trajnimin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, me trajnerin Skënder Gashi dhe trajnimin “Roli i aktivitetave kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore” me trajnerin Ahiret Mehmeti.



Në bashkëbisedë me pjesëmarrësit e të nëntë grupeve të trajnimit ka bashkëbiseduar koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke dhënë sqarime përrjedhën e trajnimeve, por edhe duke u përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve. Këtë institucion të respektuar arsimor e ka vizituar edhe drejtoresha e Arsimit të Prizrenit Luljeta Veseli –Gutaj, e cila ka parë nga afërr rjedhën e trajnimeve e pastaj edhe ka zhvilluar një bashkëbisedë me përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe me drejtoreshën Gajvazi lidhur me rrjetat aktuale në arsim.

dhe angazhimet e shumta në shërbim të arsimit dhe të realizimit të kërkesave legjitime të punëtorëve arsimor në këtë komunë. Kryetari i Vushtrrisë z. Ferit Idrizi ka shprehur respekt për gjithë angazhimet e SBASHK-ut duke u premtuar se do të vazhdohet me komunikimin korrekt dhe me angazhimet e përbashkëta në shërbim të arsimit në këtë komunë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Pas kësaj përfaqësuesit e SBASHK-ut janë gjendur në ambientet e Shtëpisë e kulturës "Hasan Prishtina"

për të marrë pjesë në Kuvendin e punës së Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë. Në hapje të këtij takimi kryetari Visar Sadriu ka bërë një shpalosje të aktiviteteve në nivel komunal dhe ka falënderuar përfaqësuesit e nivelit qendror të SBASHK-ut. Kryetari Jasharaj në fjalën përshtendetëse ka shprehur respekt për unitetin e anëtarësisë në këtë komunë dhe për respektin që ata tregojnë për të dhe për stafin qendror. Pas kësaj është zhvilluar bashkëbisedë dhe në pyetjet e pjesëmarrësve janë përgjigjur nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Kuvend pune në Suharekë

Takim me kryetarin e komunës Bali Muharremi e drejtorin e arsimit z.Bajselmani

Duke realizuar agjendën e pjesëmarrjes në takimet e Kuvendeve të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në komunat e Kosovës kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkyetaren Vjollca Shala dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar komunën e Suharekës. Para se të takoheshin me veprimtarët sindikalë përfaqësuesit e SBASHK-ut të shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Suharekës Nazim Gashi dhe anëtarja e kryesisë Lumnije Suka kanë vizituar Kuvendin Komunal dhe janë takuar me kryetarin Bali Muharremi dhe me drejtorin e arsimit Remzi Bajselmani.



Kryetari Jasharaj ka falënderuar kryetarin Muharreni dhe drejtorin Bajselmani për mikpritjen dhe i ka falënderuar ata për bashkëpunimin korrekt me kryetarin e sindikatës sonë në përpjekje për të realizuar kërkesat legitime të anëtarësisë. Pas kësaj nënkyetarja Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymeri kanë treguar për sfidat dhe për angazhimet e SBASHK-ut në situatën aktuale.



Kryetari i Suharekës ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe bashkë me drejtorin e arsimit kanë lavdëruar angazhimet e kryetarit të sindikatës sonë Nazim Gashi në shërbim të anëtarësisë dhe është shprehur i bindur se edhe në të ardhmen do të vazhdojë ky bashkëpunim korrekt.

Pas kësaj në ambientet e gjimnazit "Jeta e re" është zhvilluar Kuvendi i punës i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Suharekës. Në hapje të këtij takimi kryetari Nazim Gashi pa përshtendetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut. Ai pastaj ka shpalosur disa nga aktivitetet e zhvilluara sindikale në këtë komunë.



Kryetari Jasharaj në fjalën përshtendetëse ka përgëzuar koleget e kolegët për unitetin e treguar në momentet tepër të vështira, por edhe në vazhdimësi për t'i falënderuar edhe për përkrahjen që ata i kanë dhënë gjatë gjithë angazhimeve në përpjekje për të realizuar kërkesat legitime. Në vazhdim të takimit pjesëmarrësit në bashkëbisedë me përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë pyetur për çështje aktuale duke marrë përgjigje konkrete nga nënkyetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Takimi ka kaluar në një atmosferë respektive e mirëkuptimi dhe pjesëmarrësit janë shprehur se do të vazhdojnë rrugëtimin duke ruajtur unitetin dhe duke mbështetur gjithë angazhimet e kryetarit dhe stafit qendror në shërbim të realizimit të detyrave konkrete.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Vazhdoi të realizohej agjenda e takimeve me veprimtarë sindikalë

Kuvend pune i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Lipjan

Në muajin shkurt e duke realizuar agjendën e takimeve me veprimtarë sindikalë në komunat e Kosovës kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkyetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar edhe komunën e Lipjanit. Fillimi i tij ka qenë shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë këto komunë Emrush Ahmeti dhe anëtaret e kryesisë Lutfije Ibrahimini e Valbona Kryeziu kanë vizituar Drejtoren e Arsimit dhe janë takuar me drejtoren Rasim Hasani.



Kryetari Jasharaj ka falënderuar drejtoren Hasani për mikpritjen dhe pastaj ka shpalosur disa nga angazhimet sindikale për ta falënderuar drejtoren e arsimit dhe institucionet komunale për bashkëpunimin korrekt me kryetarin dhe kryesinë e sindikatës sonë për këtë komunë duke vlerësuar përkushtimin dhe angazhimet e kryetarit Ahmeti dhe veprimtarëve të tjera në shërbim të realizimit të kërkesave të anëtarësisë në këtë komunë. Në kuadër të kësaj bashkëbisede nënkyetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm kanë treguar për situatën aktuale dhe për angazhimet sindikale të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe për kontributin në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim duke veçuar edhe organizimin të tetë trajnimeve të licencuara të SHBASHK-ut.



Drejtori i Arsimit të Lipjanit Rasim Hasani është shprehur se ka një përvojë të gjatë e të mirë të komunikimit e bashkëpunimit me SBASHK-un e pastaj ka treguar për angazhimet që bëhen në këtë komunë në shërbim të arsimit. Në shenjë respekti të ndërsjellë drejtoren Hasani bashkë me pjesëtarë të stafit të tij kanë bërë foto me

mysafirët. Pas kësaj në sallën e Asamblesë komunale ka filluar takimi me anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Lipjanit. Kryetari i këtij Kuvendi Emrush Ahmeti ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut që janë pjesë e këtij Kuvendi pune. Ai pastaj ka bërë një raport të shkurtër lidhur me sfidat dhe angazhimet sindikale në këtë komunë.

Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari Jasharaj ka falënderuar pjesëmarrësit e këtij takimi dhe gjithë anëtarësinë në Lipjan për unitetin e dështuar dhe për mbështetjen e vazhdueshme të tyre në angazhimet e SBASHK-ut. Ai ka ftuar pjesëmarrësit që të vazhdojnë me angazhimet dhe që lirshëm të shtrojnë pyetje për të gjitha çështjet sindikale.



Nënkyetarja e SBASHK-ut pas kësaj është ndalur veçmas të çështja e trajnimeve të SBASHK-ut, që janë të licencuara nga MASHTI duke kujtuar se gjithë këtë angazhim stafi qendror në koordinim me kryetarët e nivelit komunal sindikalë e bëjnë për të ndihmuar anëtarësinë që më lehtë të realizojnë kërkesat e përditshme në profesionin e mësimdhënësit me qëllim të ngritisë së vazhdueshme të cilësisë në arsim.



Në pjesën e dytë të këtij takimi është zhvilluar bashkëbisedë mes pjesëmarrësve dhe përfaqësuesve të nivelit qendror të SBASHK-ut. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë fillimi i sqarimeve përcaktuese të cilat janë përgjigjur edhe pyetjeve të anëtarëve të këtij Kuvendi.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Kuvend pune dhe takim me veprimtarë sindikalë në Podujevë

Pjesëmarrësit shprehin respekt për përkushtimin e SBASHK-ut

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vazhduar me vizitat nëpër komunat e Kosovës për të marrë pjesë në kuvende pune, por edhe për të parë nga afër rrjedhën e trajnimeve, që vazhdojnë të organizohen edhe në muajin shkurt. Kështu ishte edhe në komunën e Podujevës.



Kryetari Jasharaj e organizatori për organizim të brendshëm Ymeri të shoqëruar nga Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar për këtë komunë Fadil Halimi para se të niste takimi me veprimtarët sindikalë kanë vizituar koleget e kolegët, që po merrnin pjesë në trajnimet e licencuara të SBASHK-ut në MASHTI.



Një numër i konsideruar i mësimdhënësve, të ndarë në tri grupe, po mbanin trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët Xhelal Krasniqi, Nexhmedin Gruda dhe Kadri Hyseni.



Drejtori i shkollës “Shaban Shala” Nysret Ismajli ishte kujdesur që pjesëmarrësit e këtij aktiviteti të punojnë në kushte të mira pune. Kolege e kolegë nga Podujeva ishin edhe në një grup tjetër në shkollën “Naim Frashëri” me trajnimin “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie

dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore”, udhëhequr nga trajnerja Pranvera Haziri.



Kryetari Jasharaj ka përgëzuar pjesëmarrësit e këtij aktiviteti që edhe në ditë vikendi po angazhohen për të marrë njohuri të reja nga programet kompjuterike për t'i aplikuar pastaj ato në procesin mësimor. Jasharaj ka shprehur respekt meritor për trajnerët e angazhuar në Podujevë, të cilët po angazhohen maksimalisht për të realizuar në përpikëri kërkesat e këtij aktiviteti.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Podujevën, Fadil Halimi duke përshëndetur pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve ka falënderuar stafin qendror të SBASHK-ut që vazhdon me angazhimet që edhe ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë. Pas kësaj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri pjesëmarrësve u ka dhënë sqarime për rrjedhën e këtij aktiviteti dhe për testimin e njohurive të arritura që do të bëhet pasi të jetë kryer trajnimi për tri modulet e para. Ai pastaj ka vazhduar bashkëbisedën me pjesëmarrësit e trajnimeve duke u përgjigjur në pyetjet e tyre.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Duke hapur takimin me veprimtarët sindikal kryetari i këtij Kuvendi Fadil Halimi ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar kryetarin Jasharaj dhe koordinatorin Ymeri për bashkëbisedën përbajtjesore me pjesëmarrësit në të katër grupet e trajnimeve dhe për pjesëmarrjen në këtë Kuvend pune. Ai pastaj ka bërë një rikujtim të aktivitetave sindikale që janë zhvilluar në këtë komunë. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka falënderuar drejtorin e shkollës "Shaban Shala", z. Nysret Ismajli për mikpritjen dhe për angazhimet që edhe trajnimet dhe Kuvendi i punës të zhvillohen në kushte shumë të mira pune. Pas kësaj

Përfaqësuesit e SBASHK-ut vizituan edhe Suharekën Respekt i lartë e meritor për stafin qendoror të SBASHK-ut

Me të përfunduar të vizitës në Prizren kryetari Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar edhe shkollën "Destan Bajraktari" në Suharekë dhe bashkë me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Nazim Gashi kanë bashkëbiseduar me koleget e kolegët që po përcillnin trajnimet trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", udhëhequr nga trajnerja Bahrije Elshani e trajneri Emin Hoxha dhe trajnimin "Roli i aktivitetave kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore", udhëhequr nga trajnerja Esengj Dinovci.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Nazim Gashi ka përshëndetur pjesëmarrësit e këtyre aktivitetave duke shprehur respekt meritor për stafin qendoror të SBASHK-ut, që krahas shumë angazhimeve, po angazhohet vazhdimit përfundimtës pasur rrjedhë të mbarë ky aktivitet.



Jasharaj ka shprehur respekt për unitetin e kolegeve e kolegëve në Podujevë dhe për angazhimin e mbështetjen e tyre ndaj stafit qendoror të SBASHK-ut. Në vazhdim të këtij takimi pjesëmarrësit kanë shtruar pyetje që kishin të bënин me aktualitetin dhe për angazhimet sindikale. Në këto pyetje e duke u bazuar në argumente e faktës eshtë përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm të SBASHK-ut Ymer Ymeri. Kryetarët e shoqatave sindikale janë shprehur se do të shtojnë angazhimet me qëllim që procesi i regjistrimit të anëtarësisë të përbyllet me sukses të plotë.

Kryetari Jasharaj ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i përgëzuar për vullnetin që edhe në ditë vikendi të angazhohen për arritjen be njojhurive të reja dhe për unitetin e treguar në të gjitha angazhimet dhe aktivitetet e SBASHK-ut. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime përrnjedhën e trajnimeve dhe u eshtë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve.

Do kujtuar se gjatë vikendeve aktiviteti i trajnimeve eshtë zhvilluar edhe në Skenderaj e komunat tjera. Duke respektuar vullnetin e anëtarësisë së SBASHK-ut në Skenderaj janë organizuar grupe trajnimesh për trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", me trajnerin Safet Beqiri dhe trajnimi "Roli i aktivitetave kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore" me trajneren Arberina Hajzeri, e cila eshtë ndihmuar të dielën nga trajnerja Pranvera Haziri.



Me pjesëmarrësit e këtij aktiviteti ka qëndruar kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Ramiz Polaci, i cili duke përgëzuar koleget e kolegët për pjesëmarrje në këtë aktivitet ka shprehur respekt meritor për stafin qendoror të SBASHK-ut, që

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

përveç në angazhime të shumta, po jep kontribut me vlerë për realizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm , që mundëson marrjen e njohurive të reja , që ju shërbejnë në punë e përditshme në arsim. Stafi qendror nuk ka pasur pushim as të dielave sepse koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me zyrtarin ligjor Blendor Shatri kanë shkuar në Drenas për të realizuar me sukses testimin e njohurive të pjesëmarrësve në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Në këtë aktivitet ata janë shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimimit Parauniversitar për këtë komunë, Ilaz Dervishi, i cili ka shprehur respekt për angazhimin e stafit qendror në shërbim të anëtarësisë.



Ata po ashtu kanë vizituar pjesëmarrësit në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, udhëhequr nga trajnerja Valmire Mehmeti Kastrati. Edhe me pjesëmarrësit e këtij trajnimi është zhvilluar një bashkëbisedë dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime lidhur me rrjetdhënë e trajnimit dhe për testin e njohurive të fituara që do të mbahet pas përfundimit të këtij aktiviteti. Ai po ashtu u është përgjigjur edhe pyetjeve të pjesëmarrësve lidhur me çështje aktuale arsimore e sindikale.



Vikendet i kanë gjetur në aktivitete sindikale edhe një numër të konsideruar të kolegeve e kolegëve tjerë të komunës së Suharekës. Dy grupe me sukses vijuan trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerët Bahrije Elshani dhe Emin

Hoxha, ndërsa grupi i tretë trajnimin “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore” udhëhequr nga trajneri Ahiret Mehmeti. Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Nazim Gashi vazhdimisht ka qëndruar me pjesëmarrësit e trajnimeve dhe është kujdesur që ky aktivitet të zhvillohet në kushte të mira pune.



Ky aktivitet i SBASHK-ut ka vazhduar edhe të dielën e 26 shkurtit në Skenderaj me trajnimin “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar “ me trajnerin Safet Beqiri, ndërsa në Drenas nën monitorimin e koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe anëtares së stafit qendror Afërdita Ahmeti është zhvilluar testi i njohurive të arritura në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie “,, që ishte mbajtur nën udhëheqjen e trajneres Valmire Mehmeti-Kastrati dhe trajneri. Një aktivitet i tillë është zhvilluar edhe në Podujevë me grupin e trajnimit trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie “, që ishte udhëhequr nga trajneri Kadri Hyseni. Realizimin e këtij aktiviteti e kanë monitoruar anëtarët e stafit qendror të SBASHK-ut Vlora Rexhepi Berisha dhe Blendor Shatri.



Një grup mësimdhënësish në Drenas atyre ditëve ka vazhduar me trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie “, udhëhequr nga trajneri Fejzullah Berisha.